

URDHËR
Nr. 1417, datë 20.6.2012

PËR PEZULLIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT FINANCIAR JOBANKË “M-PAY” SHPK

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14 pika 1 shkronjat “a” dhe “i” dhe nenit 15 të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin nr. 11, datë 25.2.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar dhe të shtojcës nr. 3 pika 4 të rregullores “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010 të Këshillit Mbikëqyrës, pasi u njoha me kërkesën e subjektit financiar jobankë “M-PAY” sh.p.k. të datës 8.5.2012 dhe me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

URDHËROJ:

1. Pezullimin e licencës nr. 22, datë 31.05.2011 të subjektit financiar jobankë “M-PAY” sh.p.k. deri në datën 1 tetor 2012.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij urdhri në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, si dhe në një gazetë kombëtare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSGUVERNATORE E PARË
Elisabeta Gjoni